

AKTI I THEMELIMIT

I shoqerise tregtare me pergjegjesi të kufizuar: “ Planet Invest ” Sh.p.k.

NENI 1

Ne Sarande sot me daten 20.09.2024 shtetasit e poshteshenuar, me vullnet te lire dhe te plote krijojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar:

“ Planet Invest ” Sh.p.k.

NENI 2

Selia Qendrore e shoqerise: “ Planet Invest ” Sh.p.k. do te jete ne adresën: Vlore, Sarande, Lagjja nr 1, Rruga Butrinti, Njesi me nr. pasurie 24/49-N2, Zk.8642.

NENI 3

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise eshte pa afat te percaktuar, duke filluar afati nga dita e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Me vendim të Asamblese se Ortakeve, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise mund të ndryshoje, dhe ky vendim i dergohet menjehere per depozitim Q.K.B. per të bere shenimet e nevojshme.

NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise tregtare: “ **Planet Invest** ” **Sh.p.k.** do te jete:

Tregeti me pakice dhe shumice e mallrave dhe artikujve te ndryshem ushqimor, industrial, pije dhe duhan, krijimi dhe menaxhimi i rrjeteve Supermarket, sherbim akomodimi dhe Hotelerie si dhe Import – Export.

NENI 5

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100,000 leke (njqindmije) leke, formuar dhe nenshkruar nga 2 ortak ose 2 kuota .

- Ortaku themelues: Ilija Marini : Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 (pesedhete mije) Lekë që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Ortaku themelues: Kristina Marini : Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 (pesedhete mije) Lekë që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortakët kanë pavarësi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë mund të rritet ose zvogëlohet, mbi bazën e vendimit me shkrim që merr Asambleja e Ortakëve, i cili nënshkruhet prej saj dhe dokumentohet duke bërë dhe shënimet në regjistrin përkatës. Në këto raste, vendimi merret nga ortakët që përfaqësojnë 100% të kuotave të kapitalit themeltar.

NENI 7

Ortakët duhet të bëjnë përpjekje për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajnë sekretin e saj dhe të mos të demtojnë interesat e personave të tjerë të shoqërisë.

NENI 8

Shoqëria cel llogari bankare në lekë dhe në çdo lloj valute të huaj, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.

NENI 9

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- 1-Asambleja e Ortakëve
- 2-Administratori

Kompetencat e Asamblesë së Ortakëve dhe Administratorit do të përcaktohen në statutin e shoqërisë tregtare “ **Planet Invest** ” Sh.p.k.

NENI 10

Shoqëria do të drejtohet nga 2 Administratorë:

Z. Ilia Marini për një afat 5 vjeçar.
dhe

Znj. Kristina Marini për një afat 5 vjeçar.

NENI 11

Çdo mosmarrveshje apo konflikt që mund të lind gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë si rregull dhe përgjithësisht ortakët duhet ta zgjidhin me mirekuptim, në të kundërtën kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

NENI 12

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, vecanerisht me ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe shoqerite tregetare" (te ndyshuar).

NENI 13

Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

NENI 14

Akti i themelimit u perpilia ne 2 (dy) kopje dhe u nenshkrua rregullisht nga ortaket themelues.

Themeluesit e shoqerise

Ilia Marini

Ilia Marini


Kristina Marini

KRISTINA
MARINI
